



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2338, date 31.07.2013

Per

“Përcaktimin e sipërmarrësëve¹ me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|----------|
| 1. Znj. Alketa | Mukavelati | Kryetare |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Znj. Elkeda | Domi | Anëtare |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës 31.07.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Vleresimin e pozites dominante ne tregjet perkatese te terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale publike telefonike fikse të sipërmarrësëve¹, mbi bazen e Dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”, si dhe vendosjen e masave rregulluese”.

mori ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punes, te perbere nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

¹ Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë dhënë në Listë në Aneks 1 të këtij Vendimi.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (*ligji nr. 9918*);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- 4) “Rregullore për analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP (*Rregullorja*).
- 5) Vendim Nr. 2138 datë 2.08.2012, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Konsultim Publik”
- 6) Vendim Nr. 2336 datë 30.07.2013, Për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V E R E N:

1. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*” reflekton punën e Grupit të Punës si dhe komentet dhe vërejtjet e bëra gjatë mbledhjes.
2. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”,
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 02.08.2012-02.10.2012 dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;

- e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar të telefonisë fikse;
- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

A T E H E R E:

Për sa më sipër, mbi bazën e vlerësimit të pozitës me FNT në tregjet përkatëse të sipërmarrësve të listuar në Aneks 1, sipas Dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2336 datë 30.07.2013, të përcaktojë sipërmarrësit, sipas Listës bashkangjitur në Aneks 1, si sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse.

Zona gjeografike e tregut përkatës për sipërmarrësin e përcaktuar me FNT është zona e mbulimit me shërbim publik telefonik fiks nga rrjeti i sipërmarrësit.

2. Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT, në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet publik telefonik fiks, është i detyruar të zbatojë detyrimet e mëposhtëme sipas Ligjit 9918, dhe përcaktimeve të mëposhtëme:

- Detyrimi i mosdiskriminimit (Neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për kontroll tarife (neni 45)

2.1 Detyrimi i mosdiskriminimit përfshin ndalimin e aplikimit të tarifave të ndryshme të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në rrjetin e sipërmarrësit për operatorë të ndryshëm kombëtar origjinues (fiks apo celular), në kushte dhe rrethana të njëjta.

2.2 Detyrimi i transparencës përfshin publikimin nga sipërmarrësi të tarifës/tarifave të terminimit në rrjetin e tij si dhe te adreses së pikes së interkoneksionit me këtë rrjet.

2.3 Sipas detyrimit për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit, sipërmarrësi i përcaktuar me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin e vet, duhet:

- a) t’u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve;
- b) të mos anulohet aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;

- c) te negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) te ofroje akses te hapur ne nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjite e tjera te rendesishme, te domosdoshme per nderveprimin e sherbimeve ose per sherbimet e rrjetit virtual;
- dh) te ofroje bashkevendosje ose forma te tjera te perdorimit te perbashket, perfshire ndertesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- e) te krijojë kushtet e nevojshme per te siguruar nderveprimin e sherbimeve pike fundore – pike fundore, duke perfshirë facilitetet per sherbimet e rrjetit inteligjent ;
- ë) te ofroje akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;
- f) te interkonektoje rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

Detyrimet e mësipërme, i referohen vetëm detyrimeve për mundësimin e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin publik telefonik fikse të sipërmarrësit me FNT dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipërmarrësit.

2.4 Detyrimi për kontroll të tarifave të terminimit në rrjetin e sipërmarrësit me FNT përfshin:

- i) Tarifat e sherbimeve të terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto sherbime në rrjetin publik telefonik fikse të sipërmarrësit me FNT janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
- ii) Vlerat maksimale të tarifave të shërbimit me shumicë të terminimit të jenë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit në rrjetet e sipërmarrëve me FNT ²

| | Aktuale- 31.12.2013 ³ | Faza I | Faza II |
|---|-------------------------------------|--------------------------|---|
| | | 1.01.2014- 31.08.2014 | 1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP |
| Tarifa per minute | | | |
| Lokal | 1.5-1.95 | 1.50 | 1.34 |
| Mesatare-Njefish/dyfish | 2.5-3.25/3.5 | 2.42 | 1.77 |
| Tarife fikse për thirrje (lek/thirrje) | 0.83 | 0.53 | 0.38 |

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

² Sipërmarrësit e listës në Aneks 1 të këtij vendimi

³ Tarifa aktuale i referohet tarifave të rena dakort sipas marrveshjeve aktuale të secili operator me operatorët e tjere fikse dhe celular. Keto tarifa aplikohen deri me 31.12.2013 dhe me pas ato reduktohen sipas vlerave dhe segmenteve perkatese.

3. Siper marrësi me FNT ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregun përkatës të përcaktuar me status me FNT.
4. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregjet përkatëse për siper marrësin është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918.
5. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*” i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks 2 dhe është pjesë e tij.
6. Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
7. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURCE

**ANEKS 1. LISTA E SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE PUBLIKE TELEFONIKE FIKSE
TË PËRCAKTUAR ME FNT PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE NË RRJETET E VETA
INDIVIDUALE**

| Nr. | Emri i Sipërmarrësit |
|------------|------------------------------|
| 1 | MOBITEL WLC Sh.a. |
| 2 | IDEA TEL Sh.p.k. |
| 3 | TEL-KOM Sh.p.k. |
| 4 | SAJET Sh.p.k. |
| 5 | SABATEL Sh.p.k. |
| 6 | PRIMO Comm Sh.p.k. |
| 7 | Tele.Co&Constraction Sh.p.k. |
| 8 | VRANIGER COMM Sh.p.k. |
| 9 | ESPACE Sh.p.k. |
| 10 | EDEN Sh.p.k. |
| 11 | Salvi & Ivi Sh.p.k. |
| 12 | IVA ELEKTRONIK Sh.p.k. |
| 13 | ALMA 2001 Sh.p.k. |
| 14 | A.T.N. Sh.p.k. |
| 15 | BITRI Sh.p.k. |
| 16 | XHENI AD Sh.p.k. |
| 17 | Ej & Bi Sh.p.k. |
| 18 | NISATEL Sh.p.k. |
| 19 | RU-TEL Sh.p.k. |
| 20 | LEVIS AURA Sh.p.k. |
| 21 | FJOERS ONLINE Sh.p.k. |
| 22 | KRANER Sh.p.k. |
| 23 | FJOART Sh.p.k. |
| 24 | SINTEL Sh.p.k. |
| 25 | LEVENDI Sh.p.k. |
| 26 | ENADA ONLINE Sh.p.k. |
| 27 | FABBTEL Sh.p.k. |
| 28 | POPAJ KLODIANO Sh.p.k. |
| 29 | ALBFRUT 2005 Sh.p.k. |
| 30 | TELEKOM POSTRIBA Sh.p.k. |
| 31 | VOSKOPI Sh.p.k. |
| 32 | DOVA Sh.p.k. |
| 33 | ATEL Sh.p.k. |
| 34 | ELCOM Sh.p.k. |
| 35 | EGIS-TEL 2004 Sh.p.k. |
| 36 | TEEB CENTER Sh.p.k. |
| 37 | EDI-2004 Sh.p.k. |
| 38 | LUNAL TEL Sh.p.k. |
| 39 | ERI-G TELCOM Sh.p.k. |
| 40 | KLEOR Sh.p.k. |
| 41 | SELCOM Sh.p.k. |
| 42 | ERGTEL Sh.p.k. |
| 43 | ASC Sh.a. |
| 44 | ABISSNET Sh.p.k. |
| 45 | ABCOM Sh.p.k. |
| 46 | HYSA 2008 Sh.p.k. |

| | |
|----|--------------------------------|
| 47 | 4ALB Sh.p.k. |
| 48 | Bardhyl Tosku (P.Fizik) |
| 49 | Enkelana Comm Sh.p.k. |
| 50 | Orikum Telecomm Sh.p.k. |
| 51 | SHKODRA INTEL.TV Sh.p.k. |
| 52 | Call Me Sh.p.k. |
| 53 | Neofone Sh.p.k. |
| 54 | Info Telecom Sh.p.k. |
| 55 | ALBON Sh.p.k. |
| 56 | ALFREDI ROTA (P. Fizik) |
| 57 | A.C.T. Sh.p.k. |
| 58 | BLETA Sh.p.k. |
| 59 | SENTELL Sh.p.k. |
| 60 | FBD Sh.p.k. |
| 61 | Mobik Sh.p.k. |
| 62 | L.E.M. Sh.p.k. |
| 63 | Eralbi Computer System Sh.p.k. |
| 64 | MC Networking Sh.p.k. |
| 65 | ADAS Sh.p.k. |
| 66 | Compatel Sh.p.k. |
| 67 | Merita Xhika (P. Fizik) |
| 68 | Greta Gjini (P. Fizik) |
| 69 | A.M.B.E. |
| 70 | VASFI BALLA(p.f.) |
| 71 | Iliria Telecom A |
| 72 | Premium Net International SRL |
| 73 | ENET |
| 74 | Telegroup Albania Sh.p.k. |
| 75 | APOLL NET Sh.p.k. |
| 76 | NEOTEL ALBANIA Sh.p.k. |
| 77 | Telekomunikacion Group Sh.p.k. |



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE E TREGUT TE TELEFONISE FIKSE

- 1) Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i sherbimeve tranzite ne rrjetet telefonike publike fikse.

Dokument Perfundimtar

Korrik 2013

(MIRATUAR ME VKD NR.2336 DATE 30.07.2013)

Publikuar ne faqen e Internetit te AKEP, www.akep.al, ne seksionin 'Konsultime te Perfunduara'.